



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR**

Nr. prot.

Tiranë, ____/____/2018

Lënda : Dërgohet raporti vjetor i monitorimit për vitin 2017.

DREJTORISË SË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Në përgjigje të shkresës nr. 147/1, datë 20.02.2018, mbi raportin e monitorimit të vitit 2017, bashkëlidhur do të gjeni relacionin dhe anekset përkatëse të monitorimit për vitin 2017, për programin "Transporti Detar".

DREJTUESE E EKIPIT TË TRANSPORTIT DETAR

Edesa Metaj

Konceptoi: N. Hajderi

Datë : 26.02.2018

E. Thana

RELACION MBI RAPORTIN VJETOR TË MONITORIMIT 2017 PROGRAMI TRANSPORTI DETAR

Në programin buxhetor "Transporti detar" për vitin 2017, buxheti në total prej 182,7 milion lekë është realizuar në shumën 132,4 milion lekë, ose 72,4 % kundrejt planit.

Realizimi i produkteve, është pasqyruar si më poshtë :

Produkti A. Administrata e Drejtorisë së Përgjithshme Detare, funksionale, planifikimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korrente (paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative) është në vlerën 102,6 milion lekë dhe realizimi financiar vjetor është në vlerën 97,5 milion lekë ose në masën 95 % ndaj planit.

Produkti B. Ndërmarrja e Kontroll Shfrytëzimit të Mjeteve Ujore për vitin 2017, planifikuar fondi 3 milion lekë dhe realizimi financiar është në vlerën 2 milion lekë, ose në masën 67,1 % ndaj planit, me të cilën janë paguar pagat e punonjësve për periudhën janar– gusht 2017, aktualisht në status konservimi. Buxheti i pa realizuar erdhi si rrjedhojë e largimit nga puna të nëpunësit autorizues të nivelit të dytë të kësaj ndërmarrje ne fund te gushtit 2017. Emërimi i nëpunësit të ri autorizues të nivelit të dytë, u finalizua në fund të vitit 2017.

Produkti C. Projekti "Ndërtim i sistemit të LRIT", me buxhet prej 40 milion lekë, nuk pati realizim financiar. Kjo për shkak të pamundësisë së kryerjes në kohë të realizimit të procedurës.

Produkti D. Projekti "Ndërtim i godinës së Kapitenerisë Sarandë", me buxhet prej 24 milion lekë, realizim financiar në shumën 22,8 milion lekë, ose 95% kundrejt planit e realizuar. Ka përfunduar investimi dhe është marrë në dorezim godina e e re.

Produkti E. Projekti "Ndërtim i godinës së Kapitenerisë Shengjin", me buxhet prej 10 milion lekë, realizim financiar në shumën 10 milion lekë, ose 100 % kundrejt planit e realizuar. Investimi është në proces. Gjatë vitit 2017 , u realizuan 60 % e punimeve dhe pjesa tjetër e investimit, do të perfundojë brenda gjashtë mujorit të parë të vitit 2018.

Për këtë program në buxhetin e vitit 2017, u planifikuan fonde për mbështetjen buxhetore në zërat Tvsh e taksë doganore, në shumën 500 mijë lekë dhe Kosto lokale në shumën prej 82,5 milion lekë, per projektin e rehabilitimit te kalates se Portit Vlore. Me Aktet Normative nr.2 dhe nr.3 të vitit 2017, në zërin TVSh dhe taksë doganore, buxheti u pakësua në shumen 80 milion lekë. Konkretisht, në të dy këto zëra buxheti prej 3 milion lekë, nuk pati realizim financiar.

DREJTUESE E EKIPIT TË TRANSPORTIT DETAR

Edesa Metaj

